**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.pot.02-615/03-0079607/23 të datës 01 nëntor 2023, nxjerr;

**V E N D I M**

**Neni 1**

Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve të krijuesve në aktivitetin letrar ***Takimet e Kulturës "Kadri Kadriu" – 2023,*** në fushat; ***Poezi, Ese dhe Tregim i Shkurtër***, sipas konkursit letrar të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, publikuar më 04 tetor 2023, formohet komisioni në këtë përbërje:

- Xheladin Çitaku, *Shkrimtar,* Kryesues
- Ramë Oraca, *Shkrimtar,* anëtar
- Shaban Pllana, *Shkrimtar,* anëtar

**Neni 2**

Komisioni bën vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve letrare në fushat sipas këtij vendimi në përputhje me kriteret e konkursit përkatës, si dhe përgatit informatë në formë të shkruar të cilën i'a paraqet Zyrës së Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - DKRS.

**Neni 4**

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*
*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS*
*Anëtarëve të komisionit, përmes DKRS-së*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot:** 02-020/04-0079804/23
**Podujevë, datë:** 01.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, datë 01.11.2023, merr:

## V E N D I M
## PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

### Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Thirrjes publike të datës 05.10.2023 për financimin e projekt propozimeve individuale, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës, ngritet Komisioni ad-hoc në këtë përbërje:

-Ardonis Isufi, kryesues
-Arbër Sfishta, anëtar
-Blerina Fejzullahu Kika, anëtare

### Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Anëtarëve të komisionit (përmes kryesuesit)*
*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sporitt*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot.**02-200/04-0079807/23
**Podujevë, datë,** 01.11.2023

**Kryetari I Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, nxjerr:

## VENDIM
## PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ- ve NË KOMUNËN E PODUJEVËS

**Neni 1**

Për shqyrtimin e aplikacioneve për financimin publik të OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve sportive të projekt propozimeve të klubeve dhe Shoqatave sportive, themelohet komisioni në përbërje:

- Alban Shabani, kryesues
- Blerina Fejzullahu Kika , anëtare
- Shkurte Musa , anëtare
- Vehbi Kastrati, anëtar – shoqëria civile
- Gazmend Ahmeti, anëtar – shoqëria civile

Agim Idrizi, zyrtar për rini-DKRS, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

**Neni 2**

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
*Anëtarëve të Komisionit*
*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.prot.** 02-020/04-0079805/23
**Podujevë, datë:** 01.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit "Furnizim me mëshqerra ", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0055847/23, të datës 02.08.2023, Për Shqyrtimin edhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0046979/23, të datës 11.07.2023, merr:

**V E N D I M**

**Neni 1**

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 130 (Njëqind e tridhjetë) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për projektin "Furnizim mëshqerra".

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike për aplikim në projektin *"Furnizim me mëshqerra"*, përkatësisht fermerët përfitues do të participojnë 30% të vlerës së projektit, kurse pjesa tjetër e projektit mbështetet nga Komuna.

**Neni 2**

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

**Neni 3**

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: *"Furnizim me mëshqerra"* sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. prot** 02-400/04-0079857/23
**Podujevë, datë** 01.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-016/01-0079821/23, datë 01.11.2023, nxjerrë këtë;

## VENDIM
## PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË GJIMNAZIT "ALEKSANDËR XHUVANI" NË PODUJEVË

**Neni 1**

**z.Naim Raçi,** nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimit [illegible], me kualifikim Baçelor i Matematikës- Arsimor - Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore,

**Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të Gjimnazit "Aleksandër Xhuvani" në Podujevë.**

**Neni 2**

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

**Neni 3**

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Neni 5**

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*U dërgohet:*
*Të emëruarit*
*Drejtorisë së Arsimit*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr. prot.** 02-020/05-0079863/23
**Podujevë, datë:** 01.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.02-020/02-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerrë këtë;

## VENDIM
## PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR SHËNIMIN E 28 NËNTORIT - DITËS SË FLAMURIT KOMBËTAR DHE SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

### Neni 1

Për shënimin e 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar dhe 111 Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ngritët Këshilli Organizativ, në këtë përbërje:

- **Pajtim Balaj**, *Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit,* kryesues
- **Edonë Çitaku**, *shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës,* anëtare
- **Xhevrie Beqiri**, *u.d. Drejtoresh e Drejtorisë së Administratës,* anëtare
- **Bahri Selimi**, *Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,* anëtar
- **Fatri Zhitija**, *Zëdhënës i Komunës së Podujevës,* anëtar
- **Gent Jetullahu**, *zyrtar në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës,* anëtar

### Neni 2

Këshilli Organizativ sipas këtij vendimi, organizon dhe bashkërendon aktivitetet për shënimin dhe manifestimin sa më dinjitoz të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar dhe 111 Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Iu dërgohet:*
*Anëtarëve të Këshillit*
*QSHQ - Arkivit*

**Nr.Prot.**02-020/04-0081201/23
**Podujevë, datë:** 08. 11. 2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, dhe të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

## V E N D I M
## PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT
**nr. prot. 02-020/04-0015276/23, datë 23.02.2023**

**Neni 1**

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komisionit sipas Vendimit nr. prot. 02-020/04-0015276/23, datë 23.02.2023 për vazhdimin e implementimit të projektit "Subvencionimi i Investimeve në Kapacitetet Prodhuese të NMVM-ve" sipas Ftesës publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, dhe atë:

-Në vend të **Mimozë Restelica-Sejdiu**, për shkak të angazhimit në punë dhe detyra tjera shtesë në pozitën e zyrtarit kryesor financiar, në cilësinë e kryesuesit të Komisionit caktohet **Alban Shabani**, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, dhe

-Në vend të **Xhevrie Beqiri**, për shkak të emërimit u.d. Drejtore e Drejtorisë së Administratës, në cilësinë e anëtarit të Komisionit caktohet **Arbrim Idrizi,** zyrtar ligjor në Zyrën Ligjore

**Neni 2**

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr. nr. prot. 02-020/04-0015276/23, datë 23.02.2023.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Anëtarëve të komisionit*
*Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot.**02-020/04-0081205/23
**Podujevë, datë,** 08. 11. 2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, merr;

**VENDIM**
**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE**

**Neni 1**
Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 33,550.oo€, ndihmë për njëqindeshtatëdhjetetre (173) personave me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike -sociale sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

**Neni 2**
Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Neni 3**
Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

**Neni 4**
Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

**Neni 5**
Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Neni 6**
Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.prot**02-422/01-0082550/23
**Podujevë, datë**16.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0080616/23, të datës 06.11.2023, merr:

## V E N D I M
## PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

### Neni 1

**z.Bejtush Bejta,** nga Podujeva, për trajtimin mjekësor të bashkëshortes së tij Vlora Bejta, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor jashtë vendit i jepet ndihmë financiare në shumë 1000€.

### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të përmendurit.

### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*-DSHMS.*
*-DBF*
*-QSHQ/Arkivit.*
*z.Bejtush Bejta (njoftohet përmes DSHMS-së)*

**Nr.prot** 02-400/04-0082679/23
**Podujevë, datë,** 16.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, merr këtë;

## VENDIM
## NGRITET KOMISIONI PËR FURNIZIM ME CERTIFIKATA

**Neni 1**

Ngritet komisioni për furnizim me certifikata në Ministrinë e Punëve të Brendshme – Agjencia e Regjistrimit Civil në këtë përbërje;

1. **Arianit Shaqiri,** udhëheqës i sektorit të gjendjes civile - kryesues
2. **Ramadan Plakolli**, zyrtar i gjendjes civile - anëtar
3. **Avni Maksuti,** zyrtar i gjendjes civile - anëtar

**Neni 2**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Administratës.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:*
*Anëtarëve të komisionit*
*QSHQ/Arkivit.*

**Nr.prot** 02-020/01-0082693/23
**Podujevë, datë** 16.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor " (ReLOaD2), merr:

## V E N D I M
## PËR FORMIMIN E KOMISIONIT Të ANKESAVE NË PROJEKTIN ReLOaD2

**Neni 1**

Formohet Komisioni i ankesave në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor " (ReLOaD2), në këtë përbërje:

Majlinda Gashi, kryesuese
Alban Shabani, anëtar

Genc Gashi, anëtar rezervë, në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.

**Neni 2**

Komisioni sipas nenit 1 të këtij Vendimi ka për detyrë që të merret me shqyrtimin e ankesave të projektit ReLOaD2 konform Marrëveshjes së nënshkruar në mes të Komunës së Podujevës dhe Projektit ReLOaD2.

**Neni 3**

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-020/04-0062782/23, datë 23.08.2023.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Anëtarëve të Komisionit*
*QSHQ/Arkivës*

**Nr.prot.** 02-020/04-0082768/23
**Podujevë, datë:** 17. 11. 2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronjat e) f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, neneve 16, 19 paragrafët 1.5; 1.6 dhe nenit 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 të Vendimit nr.prot.01-016/01-0079532/23 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi", të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 tetor 2023, merr,

## VENDIM
## PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "EKO-LLAPI" SH.A. NË PODUJEVË

### Neni 1
Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A. në Podujevë, emërohet,

**z.Fatlum Osmani,** ***Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave***

### Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimit e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

### Neni 3
Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-016/01-0079532/23 të datës 31 tetor 2023.

### Neni 4
Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*
*Të emëruarit*
*Anëtarëve të Komisionit*
*Arkives*

**Nr.Prot.** 02-020/04-0083474/23
**Podujevë, datë:** 22.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

02. 11. 2023

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 5 shkronja c) 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 19 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2023, mori këtë:

### VENDIM
### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE – "EKO-LLAPI" SH.A.

Neni 1

1. Ngritet Komisioni Komunal i Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale - "Eko-Llapi" Sh.A. Podujevë, në përbërje si vijon:

z. Bahri Blakçori, i emëruar nga Kuvendi i Komunës
z. Burim Hasani, i emëruar nga Kuvendi i Komunës

2. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë emëron një anëtar/e në kuadër të këtij Komisioni.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligjit nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0079532/23
Podujevë, datë: 31.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenet 16, 61 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 11 paragrafi 1 dhe nenit 17 paragrafi 1.10 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve, Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.prot.02-400/01-0022116/23 të datës 24.03.2023, për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin e 16 bizneseve përfituese në Komunën e Podujevës, si dhe në rekomandim të datës 01.08.2023 të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0015276/23 datë 23.02.2023 për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, Kryetari i Komunës merr;

**V E N D I M**

**Neni 1**

**Rina's Bakery and Caffe Sh.P.K,** Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar – NUI 811981184, mbështetet me mjete financiare në shumë 6,456.38 €.

**Neni 2**

Subvencionimi bëhet sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, të publikuar nga Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në emër të kompensimit të mjeteve financiare për sigurimin/ blerjen e pajisjeve nga ana e përfituesit me qëllim të implementimit të projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve.

**Neni 3**

Mbështetja financiare bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës.

**Neni 4**

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe përmes bankës barten në llogarinë e **Rina's Bakery and Caffe Sh.P.K.**

**Neni 5**

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.prot,** 02-400/04-0083819/23
**Podujevë, datë,** 23.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronjat b) c) g) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16, 19 paragrafi 1.6 dhe nenin 61 paragrafët 1.2; 1.3 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerrë këtë;

## V E N D I M
## PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES

### Neni 1

Në funksion të zhvillimit dhe zbatimit të masave ndërgjegjësuese lidhur me menaxhimin e integruar të mbeturinave, si dhe fushave tjera relevante që ndërlidhen me çështjet e tyre, ngritët Grupi Punues në këtë përbërje:

- **Michell Rohmann**, *ekspert i jashtëm i integruar nga Organizata GIZ,* kryesues
- **Avni Syla**, *Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,* anëtar
- **Remzi Kodraliu**, *Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit,* anëtar
- **Selman Gashi**, *Drejtoria e Arsimit,* anëtar
- **Albert Ajvazi**, *Drejtoria e Administratës - në cilësinë e zyrtarit përkthyes,* anëtar

### Neni 2

**1.** Grupi punues sipas këtij vendimi, bën analiza dhe identifikimin e potencialeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar me Qytetin simotër Velbert të Gjermanisë, në fushën e menaxhimit të mbeturinave, sensibilizimin e aktorëve përkatës dhe fillimin e hapave të parë.

**2.** Gjithashtu ky Grup Punues, angazhohet në përditësimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 në Komunën e Podujevës, përcaktimin e prioriteteve të qarta, zhvillimin e masave drejt zbatimit ku si prioritet i parë është përditësimi i bazës së të dhënave të klientëve për tarifat e mbetjeve.

### Neni 3

Për punën e kryer, në formë të shkruar informohet Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, si dhe Drejtoritë dhe shërbimet tjera varësisht nevojave të paraqitura.

### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I'u dërgohet;*
*DSHPMSH dhe Anëtarëve të Grupit Punues.*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.prot.** 02-020/04-0084226/23
**Podujevë, datë;** 27.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Ne bazë neneve 13 dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Arsim Parauniversitar nr.04/L-032, Planin Nacional të Qeverisë për Aftësinë e Kufizuar në Kosovë 2013-2023, nenin 3 pika 2.5 të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.16/2017 - vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, neneve 16 dhe 19 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës nr.prot01-020/01-0050862/18, në kërkesë të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr.prot.02-016/01-0083945/23, mori këtë:

# V E N D I M
# PËR EMËRIMIN E EKIPIT VLERËSUES PEDAGOGJIK NË KOMUNËN E PODUJEVËS

### Neni 1

Me këtë vendim emërohen anëtarët e Ekipit vlerësues pedagogjik dhe përkrahës për fëmijët me nevoja të veçanta, në këtë përbërje:

| | |
|---|---|
| 1.**Selman Gashi**, *Zyrtar për çështje pedagogjike në Drejtorin e Arsimit,* | koordinator i Ekipit |
| 2.**Dafina Arifi**, *psikologe,* | anëtare |
| 3.**Blerim Vllasa**, *Koordinator kundër braktisjes së mësimit (EPRBM),* | anëtar |
| 4.**Ormirë Dibrani**, *punëtore sociale,* | anëtare |
| 5.**Remzie Hoxha Gërguri**, *mësimdhënëse e klasës së bashkëngjitur,* | anëtare |
| 6.Eksperti, varësisht nga karakteristikat e dëmtimit të fëmijës, | anëtar/e |

### Neni 2

**Detyrat e Komisionit profesional** sipas Udhëzimit Administrativ të lartcekur, ndër të tjera janë;

- Vlerësimi i aftësive psikologjike, shëndetësore, pedagogjike, interesimet dhe nevojat e fëmijëve në procesin edukativo-arsimor,
- Vendos sipas nevojës që t'i mbështesë fëmijët me nevoja të veçanta edukativo-arsimore, të ofrojë shërbime sociale brenda arsimit të rregullt siç janë: mbështetja nga mësimdhënësi gjithëpërfshirës ose arsimtari udhëtues, të korrigjojë të folurit ose të mësojë shtesë nga mësimdhënësit, terapi e gjuhës, udhëzime të specializuara, ndihmë mjekësore për fëmijët sipas dëmtimeve etj.
- Ka kompetenca që të propozojë, orientoj, vlerësoj dhe të marr vendim për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, sipas nevojës individuale të fëmijëve dhe mundësive ekzistuese,
- Të rekomandojë pajisje të nevojshme që nevojiten për mësimdhënie dhe mësimnxënie për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

**Neni 3**

Me hyrjen në fuqi të këtij vendim, shfuqizohet vendimi nr.05/579 të datës 04.10.2021, mbi emërimin e anëtarëve të komisionit profesional, vlerësues dhe përkrahës për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*-Drejtorisë së Arsimit -DKA*
*-Anëtarëve të Komisionit – përmes DKA*
*-QSHQ/Arkivit.*

**Nr.Prot.** 02-020/04-0084696/23
**Podujevë, datë,** 29.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, duke iu referuar shkresës elektronike datë 27.11.2023 të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) në kuadër të Ministrisë së Financave Punës dhe Transferove (MFPT), merr:

## V E N D I M

**Neni 1**

Ngritet Komisioni për përzgjedhjen e punëkërkuesve për angazhim në punë të 10 praktikantëve- infermier/ere në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare- QKMF- në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

Arbresha Bashota , kryesuese
Halit Vërshevci, anëtar
Nafie Gërguri, anëtare

**Neni 2**

Komisioni bën përzgjedhjen e punëkërkuesve të regjistruar si të papunë në Zyrën e Punësimit nga lista e gjerë e përgatitur dhe dërguar nga Zyra e cekur, si dhe kryen punë dhe detyra tjera të përcaktuara nga Marrëveshja e Bashkëpunimit e cila do të lidhet nga APRK dhe Komuna e Podujevës.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*
*Anëtarëve të komisionit*
*Zyra e Punësimit-Podujevë*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.prot.**02-020/04-0084694/23
**Podujevë, datë:** 29.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 4.6 të Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenet 16 dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

**VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 02-020/04-0078337/23, DATË 25 TETOR 2023**

**Neni 1**

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi për ngritjen e komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare në pronësi të Komunës së Podujevës Nr. 02-020/04-0078337/23, datë 25 tetor 2023 dhe atë:

Në vend të **Ilirian Duriqi**, në përbërjen e komisionit caktohet **Naser Rama**, zyrtar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF Podujevë.

**Neni 2**

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Nr. 02-020/04-0078337/23, datë 25 tetor 2023.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
*Anëtarëve të komisionit*
*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr. prot.**02-020/04-0084697/23
**Podujevë, datë:**29.11.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 4.6 të Rregullores MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenet 16 dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

## VENDIM
## PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JO FINANCIARE NË PRONËSI TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

### Neni 1

Për inventarizimin e pasurisë jo financiare të Komunës së Podujevës, ngritët komisioni në këtë përbërje:

**Ardian Emini**, *zyrtar në Drejtorinë e Arsimit,* *Kryesues*
**Alban Shabani**, *zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave,* *anëtar*
**Xhylfidane Nimani**, *zyrtare në Drejtorinë e Administratës,* *anëtare*
**Selatin Rexhepi**, *zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave,* *anëtar*
**Ilirian Duriqi**, *zyrtar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF* *anëtar*

Mandati i komisionit është dy (2) vite.

### Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregullore MF-nr.03/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

### Neni 3

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-020/04-0103660/21, datë 24 nëntor 2021.

*U dërgohet:*
*Anëtarëve të Komisionit*
*Zyrës së Personelit*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.prot.** 02-020/04-0078337/23
**Podujevë, datë:** 25.10.2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13,17 shkronja o) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave dhe neneve 16,19 parag.1.15 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr:

## V E N D I M
## PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT
## nr. 02-400/03-0010186/23 datë 06.02.2023

### Neni 1

**1**. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.02-400/03-0010186/23, datë 06.02.2023, për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave që i referohen emërtimeve dhe riemërtimeve të zonave të qarkullimit publik- ZQP në territorin e Komunës së Podujevës dhe atë në vend të znj.Xhevrie Beqiri caktohet:

**z.Alban Shabani,** zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme - DBF

**2**.Zëvendësimi bëhet për shkak se znj.Xhevrie Beqiri, është emëruar Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës.

### Neni 2

Pjesa tjetër e Vendimit bazë, të cekur si në paragrafin 1 të këtij neni mbetet e pandryshuar.

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendim u dërgohet:*
*Anëtarëve të Komisionit*
*DPUMM*
*DPZHE, për njoftim*
*Zyrës së personelit*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.prot.**02-020/04-0094918/23
**Podujeve, datë:** 30. 11. 2023

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**